



Prishtinë: 24.06.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_251\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_403\_05\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_403\_05\_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Luan Dalipi (lokal, shifra e konsumatorit DPR-90021423) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 13.08.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.08.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 19.07.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të dëmtuara (falsifikuara).  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 034406 të datës 19.07.2007
- Me datë 02.10.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 170620 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 172563. **Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 008855 të datës 04.12.2008
- Me datë 03.11.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit ka bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 170620, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar (numërori i kthyer mbrapa)  
**Provë:** Procesverbali me nr. 30/03 i datës 03.11.2007
- Me datë 23.07.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0116445 i datës 23.07.2008

- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 12.08.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 12.08.2008
- Me datë 13.08.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatori, ka vërejtur se:

- ✓ Personat e autorizuar për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 170620 Vulat (bllobat) shtetërore i ka të manipuluar, te hapura dhe prapë te mbyllura si dhe numëruesi i njehsorit është i manipuluar (numërori i kthyer mbrapa), ky konstatim është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë (përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura) ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar.
- ✓ Sipas analizave të bëra rrjedhjes së energjisë aktive shihet se konsumatori nga periudha 9/2004 e deri më 6/2007 nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike, përveç në muajin 10/2005 e cila sipas analizave del se është vlerë e pa matur (paushall).  
**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Në listat e leximit të KEK-ut (librin e leximeve), lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se për këtë periudhë nuk ka pasur shpenzim të energjisë elektrike pasi që objekti ka qenë i mbyllur dhe nuk punon.  
**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive dhe listat e leximit
- ✓ DMK në ZRRE, bazuar në analizën e dokumentacionit të ofruar nga KEK-u ka vërejtur se me rastin e inspektimit të parë me datë 19.07.2007 të bërë nga punëtorët e KEK-ut është konstatuar se njehsori elektrik vulat shtetërore i ka të dëmtuara (falsifikuara) si dhe konsumatori është udhëzuar që të lajmërohet në shërbimin për konsumator me qëllim të aplikimit nga konsumatori për ndërrim njehsori. Punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut në procesverbalin e datës 19.07.2007 kanë konstatuar se njehsori elektrik i ka vulat shtetërore i ka të dëmtuara (falsifikuara). Punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut nuk mund të konstatojnë se vulat shtetërore janë të dëmtuara (falsifikuara) ata mund vetëm të dyshojnë, punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit mund të konstatojnë lidhur me vulat shtetërore. Organet e KEK-ut të autorizuar për ndërrim njehsori kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik me datë 02.10.2007.
- ✓ Konsumatori deklaron se lokali nga viti 2004 deri më 2006 nuk ka punuar fare, por ka qenë i lëshuar me qira për një periudhë të shkurtër tre mujore dhe se prapë nga ajo kohë më lokali nuk ka punuar.  
**Provë:** Deklarata e konsumatorit
- ✓ DMK në ZRRE, bazuar në analizën e bërë kalkulimit të faturës së rikthimit të humbjeve të përpiluar nga departamenti i faturimit në KEK ka konstatuar se KEK-u ka gabuar ngase nuk ka respektuar nenin 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e

shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike por që KEK-u faturën e rikthimit të humbjeve e ka përpiluar bazuar në profilin e kabllit furnizues.

- ✓ Shërbimi i faturimit e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar(rikthim i humbjeve) duke u bazuar vetëm në konstatimet teknike të qendrës së kalibrimit, ndërsa nuk ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike dhe proceset e tjera.
- ✓ DMK në ZRRE ka vërejtur se konsumatori për periudhën të cilën e ngarkon KEK-u nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike dhe kjo vërtetohet edhe në listat e leximit të KEK-ut.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

- KEK-u duhet ta shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06377 e datës 29.07.2008 në vlerën 8,918.66 €

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar